

**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 21745 prot.

Tiranë, më 16, 6, 2025

V E N D I M

Nr.43, datë 10.06.2025

**“PËR
MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL
“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” I FINANCUAR ME FONDET E
BUXHETIT TË SHETIT, NË BASHKINË E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 453, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij përfamiljet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, si dhe në vijim të Raportit Përmbledhës me nr.13245 prot., datë 04.04.2025, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Raportit Përmbledhës të Komisionit të Strehimit dhe listën e individëve/familjeve që përfitojnë nga programi social “Subvencionimi i interesave të kredisë”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, sipas aneksit nr. 1 dhe nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Individët/familjet e përcaktuara në Aneksin nr. 1 dhe nr.2 të këtij vendimi, për të përfituar nga programi i kreditimit, duhet të kujdesen për gjetjen e blerjen e një banese në treg të lirë. Afati maksimal për kryerjen e procedurave të përfitimit të kredisë është 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e protokollimit të listës emërore pranë institucionit, që monitoron subvencionimin e interesave të kredisë.
3. Pavarësisht parashikimeve të pikës 2, në rastet kur individ/ familja, ende nuk ka gjetur banesën, njofton nëpërmjet postës elektronike, çdo 6 (gjashtë) muaj, institucionin financiar dhe nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, institucionin që monitoron subvencionimin e kredisë për shfaqjen e interesit dhe pamundësisë së tij për gjetjen e banesës. Mos dërgimi i këtij informacioni çdo 6 (gjashtë) muaj, përbën shkak për skualifikimin e tyre.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit të dërgojë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Entit Kombëtar të Banesave si edhe institucioneve financiare me të cilat është nënshkruar marrëveshje, një kopje të këtij vendimi së bashku me listat e përfituesve.
5. Individët/familjet që nuk janë shpallur përfitues nga programi social “Subvencionimi i interesave të kredisë”, kanë të drejtën e ankimit administrativ, pranë kryetarit të Bashkisë, brenda 5 ditëve pune nga momenti i shpalljes publike të listës së përfituesve. Ankimi duhet të depozitohet pranë zyrave të Bashkisë Tiranë dhe përcillet pranë Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe

Licencimit, e cila së bashku me dosjen e ankuesit ia paraqet Kryetarit të Bashkisë, i cili brenda 7 ditëve pune del me vendim në lidhje me ankimin e paraqitur nga ankuesit.

6. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

K R Y E T A R

MEGLI FINO

